

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Gani Avdiu e Fejzullah Rexhepi, në çështjen kontestimore të paditëses A.G. nga Prishtina, të cilin e përfaqëson avokati S.M. nga Prishtina, kundër të paditurit ANP"Adem Jashari", sh.a. Vrellë, Lipjan të cilën e përfaqëson I.D., për kompensimin e të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, C.nr. 102/11 i dt. 20.02.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 17.01.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET pjesërisht ankesa e të paditurit, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, C.nr.102/11 i dt.20.02.2014, dhe gjykohet:

DETYROHET pala e paditur ANP "Adem Jashari" sh.a. Vrellë, Lipjan, që paditësit A.G. nga Prishtina, në emër të diferencës së pagës për periudhën kohore 01.12.2010 - 03.04.2011 t'i paguaj shumën prej 3200,00€, me kamatë ë cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat më tepër se një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë 20.02.2014 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në vlerë prej 730,00 €.

REFUZOHET si e PA BAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë në shumën prej 19.220.40 €, dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 200,00€.

A r s y e t i m

Me Aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, është aprovuar kërkesëpadia e paditësit A.G., si e bazuar dhe është detyruar pala e paditur ANP" Adem Jashari" sh.a. Vrellë që paditësit ti paguaj shumën prej 22,420.40€, me kamatë vjetore 3.5%, në vlerë prej 2,140.21€, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 930€, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të saktë të gjendjes faktike dhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë të aprovoj ankesën e të paditurit, kurse aktgjykimin i goditur të anulohet dhe që lënda të kthehet për rivendosje apo që të vendos që kërkesëpadia e paditësit të hedhet poshtë si e pabazë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK, gjeti se:

Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se në bazë të kontratës së punës është Menaxher i Departamentit të Prokurimit. Padiësi ka theksuar se bordi i ANP "Adem Jashari", në një mbledhje të mbajtur, ka miratuar një strukturë të re organizative të aeroportit ku nga zyrat përkatëse i ka krijuar departamentet përkatëse, përfshirë edhe departamentin e prokurimit. Në të njëjtën mbledhje është vendosur që si udhëheqës të departamenteve të jenë drejtorët e këtyre departamenteve. Sipas pretendimeve të palës padiëse të gjithë menaxherët e deri atëhershëm janë emëruar drejtorë të departamenteve në pajtim me strukturën organizative, përveç padiësit A.G. i cili ka mbetur në pozitën e Menaxherit të Departamentit të Prokurimit, në kundërshtim me strukturën e re organizative. Padiësi ka theksuar se i ka paraqitur kërkesë në E-mail zyrtar, Drejtorit Menaxhues të ANP-së dhe Drejtorit të Burimeve Njerëzore, me kërkesë që të veprohet në pajtim me strukturën organizative që pozita e tij të jetë e një niveli të barabartë me të gjitha departamentet tjera. Padiësi pretendon se këta të fundit ndonëse kanë qenë të obliguar sipas ligjit, nuk i janë përgjigjur padiësit në kërkesën e tij dhe për këto arsye ka ushtruar padi në Gjykatën kompetente.

Nga shkresat e lëndës më tutje rrjedhë se, Gjykata e shkallës së parë ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor dhe ka administruar provat përkatëse si: kërkesën e datës 03.03.2011, shkresën mbi strukturën organizative të datës 28.01.2008, skemën organizative të datës 03.11.2008, vendimin e Bordit të Drejtorëve, të datës 10.11.2009, procesverballi i mbledhjes së 39 të Bordit të Drejtorëve të ANP-së, skema e pagave me numër protokoll nr.36 të datës 03.09.2013, ekspertiza e datës 09.09.2013, dhe ekspertiza plotësuese e datës 30.12.2013, dhe 20.02.2014, njoftimi i datës 26.04.2008, informata për listën e pagës me numër protokoll nr.05/20013 të datës 04.07.2013, vendimi i Bordit i datës 10.11.2009 etj., dhe më pas ka gjetur:

Se padiësi ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura që prej vitit 2008 dhe atë menaxher i prokurimit. Kontestues midis palëve ishte fakti se ai takon padiësit apo jo diferenca në të ardhura personale, sikur drejtorëve të departamenteve tjera duke u nis nga fakti se me ligjin për prokurimin në mënyrë automatike të gjithë menaxherët e Departamentit për Prokurim kanë pozitën e drejtorit të departamentit. Padiësi me dt.03.03.2011, me parashtresë i është drejtuar kompetentëve të të paditurës, përmes së cilës ka kërkuar që të shqyrtohet struktura organizative e ANP-së, e sipas kësaj strukture është paraparë edhe Departamenti i Prokurimit, dhe vetë pozita e udhëheqësit të Prokurimit. Në bazë të strukturës organizative është i paraparë edhe Departamenti i Prokurimit, ndërsa në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të ANP-së, janë paraparë pozitë e drejtorëve të departamenteve ndërsa pozitën për drejtor të Departamentit të Prokurimit nuk e kanë përfshi fare edhe pse me Ligjin për Prokurimin është paraparë që menaxhuesi i këtij departamenti merr pozitën e drejtorit të departamentit. Ky fakt vërtetohet edhe nga grada siç janë graduar drejtorët se vendet e drejtorëve të departamenteve janë të graduar në kategorinë C3 e ku dallimi i të ardhurave nga grada D3 ku ka qenë i përfshirë zyrtari i prokurimit. Ndërsa sipas mendimit të ekspertit të financës padiësit A.G. duhet kompensuar diferencën në pagë nga i padituri ANP, për periudhën prej 11.11.2008, e deri me 03.04.2011, në vlerë prej 20,280.19€, që së bashku me kamatë të llogaritur prej ditës së ushtrimit të padisë dt.18.03.2011 e deri me dt.20.02.2014, me normë vjetore 3.5% në shumë prej 2140.21€ arrijnë gjithsejtë shumë prej 22.420.40€. Bazuar nga të gjitha këto, Gjykata e

shkallës së parë ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, ndërsa ekspertizës së ekspertit të financës i ka falur besimin, ekspertizë kjo e cila përmban të gjitha parametrat e një mendimi profesional dhe objektiv, e që eksperti ka llogaritur shumë e të ardhurave të cilat do ti takonin paditësit si diferencë e të ardhurave nga kategoria të cilën ka qenë i paguar në D3, në kategorinë C3, kategori për të cilën edhe është dashtë te kompensohet, sepse sipas fuqisë ligjore është dashtë të radhitet në Drejtor i Departamentit i Prokurimit, madje edhe të kompensohet sipas kësaj pozite sikur edhe drejtorët tjerë e jo sipas pozitës së zyrtarit të prokurimit. Nga të lartcekurat shihet se Gjykata e shkallës së parë nuk ka theksuar se cilën normë ligjore ka zbatuar kur ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit.

Kolegji i Gjykatës së Apelit ka vlerësuar përfundimin e tillë te Gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se një qëndrim i tillë juridik nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm ngase sipas vlerësimit të Kolegjit gabimisht është vërtetuar gjendja faktike dhe është bërë edhe zbatimi i gabuar i të drejtës materiale. Kjo për faktin se pala paditëse bazimin e kërkesëpadisë e mbështet në dy linja. Sipas linjës së parë, pala paditëse thekson në pretendimet e tij se, e drejta e tij buron nga vendimi i nxjerrë në mbledhjen e 39-të të Bordit të Drejtorëve të mbajtur me 11.11.2008. Kolegji i Gjykatës së Apelit pas vlerësimit të shkresave dhe provave të marra ka konstatuar se në mbledhjen e përmendur siç del nga pika e IV e procesverbalit -Rirregullimi, dhe vendimi që është marrur në këtë mbledhje, Bordi i Drejtorëve unanimisht ka miratuar propozimin e Drejtorit Menaxhues, që deri në rregullimin përfundimtar nga kompania konsulente, pozitat e personave udhëheqës të departamenteve në vijim, që raportojnë direkt te Drejtori Menaxhues, të kenë emërtimin e njëjtë të Drejtorit dhe të jenë në nivelin e njëjtë të pagave si ai: Financë, Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Aeroportuale dhe Terminalit, Administratës, Shërbimit të Navigimit Ajror. Kolegji ka gjetur se në këtë mbledhje nuk është vendosur që të njëjtën pozitë ta ketë edhe Menaxheri i Departamentit të Prokurimit. Në shkresat e lëndës nuk ka të dhëna nëse paditësi ka kërkuar që pozita e tij në vendin e punës të rregullohet siç ka pretenduar, konform vendimeve të nxjerra në këtë mbledhje të Bordit Drejtues të ANP, apo se ka vepruar në kërkim të mbrojtjes së të drejtave të tij konform nenit 78 të Ligjit të Punës. Kolegji i Gjykatës së Apelit ka gjetur se për këtë pjesë kërkesëpadia e paditësit nuk është e mbështetur në Ligj. Për këto arsye Kolegji ka gjetur se qëndrojnë pretendimet ankimore në këtë pjesë dhe të njëjtën e ka refuzuar si të pa bazuar.

Sipas linjës së dytë, Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se e drejta e paditësit buron nga “dispozita ligjore” e Ligjit për Prokurimin Publik, ndërsa ka nuk e ka cekur se në bazë të cilit nen të këtij Ligji, ka qenë e rregulluar kjo çështje me ligjin në fuqi. Shikuar nga shkresat e lëndës, pretendimet e palëve, dhe bazuar në evidencën e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës, Kolegji ka gjetur se e drejta e pretenduar e paditësit, buron dhe gjen mbështetje në Ligjin mbi Prokurimin Publik, Ligji- 03/L-241, neni 4, 1.69 dhe Ligji mbi Prokurimin Publik, Ligji 04/L-042, neni 4, 1.43 e të cilat nene kanë përmbajtje të njëjta dhe përcaktojnë se *“Zyrtar i prokurimit është personi i caktuar si drejtor i Departamentit të Prokurimit të autoritetit kontraktues sipas paragrafit 1 të nenit 23 - të ligjit”*. Nga evidenca në Gazetën Zyrtare shihet se Ligji- 03/L-241, ka hyrë në fuqi me datën 01.12.2010, ndërsa është ndryshuar me Ligjin 04/L-042 i cili ka hyrë në fuqi me 05.10.2011. Kolegji ka gjetur se perioda kohore kur edhe buron e drejta e paditësit për kërkimin e diferencës së të ardhurave është nga data 01.12.2010 deri më 03.04.2011, që përbën periudhë prej gjithsej 4 muaj. Nga shkresat e lëndës, gjegjësisht dokumentacioni shkresor i dorëzuar nga e paditura, del se paga e Menaxherit ishte në nivelin prej 1900,00 €, kurse paga e Drejtorit të Departamentit, ishte në nivelin

prej 2700,00 €, e që ndryshimi në pagë ishte prej 800,00 € në muaj. Meqenëse periudha kur paditësi sipas ligjit kishte të drejtë në pagë në kategorinë e barasvlershme me Drejtorin e Departamentit nga kategoria D₃ në atë C₃, përbënte periudhë 4 muajshe, atëherë Kolegji ka gjetur se lartësia e detyrimit të të paditurës që t'ia kompensojë paditësit është në shumën prej 12.800,00€, (4 muaj x 800 € = 3200.00 €). Për këto arsye edhe Kolegji i ka refuzuar si të pabazuara pretendimet ankimore, dhe për këtë pjesë ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës Kolegji ka vendosur mbi bazën e suksesit të arritur në procedurë në kuptim të nenit 452.2 të LPK.

Ndërkaq sa i përket kamatës, është gjykuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, pasi që në rastin konkret kamata caktohet si ajo që vlen për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat më tepër se një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë 20.02.2014 e deri në pagesën definitive, në kuptim të dispozitave të nenit 277 të LMD.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e pajtim me dispozitat e nenit 201, par 1, pika b) të LPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr. 1599/14 me dt.17.01.2017

Kryetari i Kolegjit-Gjykatësi,
Dr.sc. Rafet Haxhaj, d.v.